

Doc.	TIA-IMS-POL-003	Politika e Energjisë dhe Karbonit	
Rish.	08		
Datë	01/07/2024		I brendshëm/I jashtëm

POLITIKA E ENERGJISË DHE KARBONIT

Mbrojtja e klimës dhe e burimeve të kufizuara të lëndëve djegëse fosile është një nga aspektet kyçe të Politikës së Energjisë dhe Karbonit të Tirana International Airport. Përdorimi eficient i energjisë, kursimi i saj dhe reduktimi i emetimeve të karbonit luan një rol kryesor në strategjinë tonë të zhvillimit dhe biznesit.

Tirana International Airport ka themeluar dhe është duke zbatuar dhe mirëmbajtur një Sistem të Menaxhimit të Energjisë të orientuar drejt standardeve ISO 50001:2018 dhe të bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të përdorimit eficient të energjisë dhe reduktimit të karbonit. Vendosja dhe rishikimi i objektivave dhe synimeve në lidhje me energjinë dhe reduktimin e karbonit është pjesë e sistemit të menaxhimit të përgjithshëm dhe punës së përditshme.

Tirana International Airport do të investojë në teknologji të reja, do të monitorojë sistematikisht, si dhe do të promovojë blerjen e produkteve dhe shërbimeve me konsum eficient të energjisë.

Sigurimi dhe disponueshmëria e burimeve dhe informacionit, si dhe përfshirja e stafit menaxhues dhe punonjësve, të cilët duhet të arrijnë këto objektiva, është një aspekt tjetër i rëndësishëm i politikës sonë. Ushtrimi i aktivitetit në përputhje me legjislacionin Shqiptar përkatës në lidhje me energjinë dhe ndryshimet klimatike është elementi bazë për arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin tonë për Menaxhimin e Energjisë dhe Karbonit.

Tirana International Airport do të orientojë partnerët e aeroportit drejt kontrollit dhe reduktimit të konsumit të energjisë dhe emetimeve të karbonit.

Politika e Energjisë dhe Karbonit është dokumentuar, komunikuar dhe publikuar në faqen e internetit të Tirana International Airport. Kjo Politikë do të rishikohet dhe përditësohet rregullisht në përputhje me kërkesat përkatëse.

Tirana International Airport, 1 Korrik 2024

Marsida Pallko
Administratore e TIA-s



Piervittorio Farabbi
Menaxher Përgjegjës i TIA-s dhe
Administrator / COO


